



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

A. nr. 536 / 20

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 dhe nenin 108/A të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-092, neni 4 Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pran autoriteti kontraktues, parashtrimin të ankesave pran OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave, si dhe nenin 17 paragrafi 3 i Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2020, me numër të protokollit 83/2020, pas shqyrtimit të ankesës së OE “VB INVEST” SH.P.K. Prishtinë, parashtruar kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Asfaltimi i rrugës në fshatin Lluga” me numër të prokurimit 613-20-1359-5-2-1”, të iniciuar nga AK Komuna e Lipjanit, Kryesuesi i Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit z. Ardian Behra me datën: 06 GUSHT 2020 mori këtë :

VENDIM

- I. **Hedhet si e pa afatshme** ankesa e OE “VB INVEST” SH.P.K. Prishtinë, me nr. të protokollit. 536/20, e datës: 04 GUSHT 2020, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Asfaltimi i rrugës në fshatin Lluga” me numër të prokurimit 613-20-1359-5-2-1”, të iniciuar nga AK Komuna e Lipjanit, pasi që e njëjta është parashtruar jashtë afatit ligjor në Organin Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) .
- II. **I LEJOHET** autoritetit kontraktues – Komuna e Lipjanit, që të vazhdoj më tutje me procedurat e prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Asfaltimi i rrugës

ne fshatin Lluga” me numër te prokurimit 613-20-1359-5-2-1”, te iniciuar nga AK Komuna e Lipjanit, përkitazi me këtë ankesë, (nëse nuk ka ankesë tjetër).

III. Ankesa e operatorit ekonomik ankues nuk mund të shqyrtohet, pasi që e njëjta nuk është e lejuar sipas nenit 108/A dhe 109 të LPP-së si dhe nenin 9 të Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pran autoriteti kontraktues, parashtrimit të ankesave pran OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave , operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës.

IV. **Obligohen**, OE ankues që konform nenit 31 pika 6 te Rregullores të Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën iu bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Më datën 03 GUSHT 2020, në ora 17:57 Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik ka pranuar ankesën e parashtruar nga ana e OE “VB INVEST” SH.P.K. Prishtinë, e cila ankesë protokollohet me nr. të protokolli. 536/20(me datën 04.08.2020) , kundër njoftimit për dhënie te kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Asfaltimi i rrugës ne fshatin Lluga” me numër te prokurimit 613-20-1359-5-2-1”, te iniciuar nga AK Komuna e Lipjanit.

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka analizuar ankesën e parashtruar nga OE “VB INVEST” SH.P.K. Prishtinë, me nr. të protokolli. 536/20, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Asfaltimi i rrugës në fshatin Lluga” me numër te prokurimit 613-20-1359-5-2-1”, të iniciuar nga AK Komuna e Lipjanit dhe konstaton se e njëjta ankese është parashtruar në OSHP, në ditën e (njëmbëdhjetë) 11 pas datës së publikimit të vendimit te AK-së, lidhur me kërkesën për rishqyrtim te vendimit te AK-së, të parashtruar nga OE VB INVEST” SH.P.K. Prishtinë.

Autoriteti kontraktues (AK) Komuna e Lipjanit për aktivitetin e prokurimit “Asfaltimi i rrugës në fshatin Lluga” me numër te prokurimit 613-20-1359-5-2-1” me Letrën Standarde për tenderuesin e eliminuar e ka njoftuar OE ankues me dt. 21.07.2020 , në ora 10:30. Operatori

ekonomik (OE) ankues kërkesës për Rishqyrtim te vendimit të AK-së e ka parashtruar me dt. 22.07.2020 ora 16:10. AK me dt. 24.07.2020 në ora 10:27, ka marr vendim për refuzim te kërkesës për Rishqyrtim.

Kundër vendimit te lartcekur me datën 03.08.2020 në ora 17:57 OE ankues në mënyrë elektronike ka parashtruar ankese në OSHP, e cila ankese protokollohet me dt. 04.08.2020 sipas orarit zyrtar, me numër te Protokollit 536/2020.

Andaj Organi Shqyrtues i Prokurimit konstaton se duke pas parasysh faktin se AK me dt. 24.07.2020 në ora 10:27, ka marr vendim për refuzim të kërkesës se OE “VB INVEST” SH.P.K. Prishtinë, afati ligjor sipas LPP-së , për parashtrim te ankesës në OSHP për OE ankues ka filluar te rrjedh nga data 25.07.2020 nga ora 08:deri në ora 16:00 deri me datën 03.08.2020 ora 16:00 (duke pas përsysh faktin se dita e njoftimit llogaritet dita 0).

Organi Shqyrtues i Prokurimit konstatojnë se OE “VB INVEST” SH.P.K. Prishtinë, ka humbur afatin kohor për parashtrim te ankesës në OSHP për faktin se afati i fundit sipas LPP-se, për ushtrim te ankesës për aktivitetin e prokurimit në fjale nga OE ankues ka qenë data 03.08.2020, ora 16:00.

Organi Shqyrtues i Prokurimit sqaron se neni 5 i LPP-së si orar zyrtar te punës te Institucioneve te Republikës së Kosovës njehe orën nga 08:00 deri në 16:00, andaj nga te cekurat si me lart vijmë në përfundim se ankese ne OSHP e datës 03.08.2020, e dorëzuar në ora 17:57, e cila ankesë protokollohet me dt. 04.08.2020 sipas orarit zyrtar, me numër te Protokollit 536/2020, është parashtruar jashtë afatit ligjor sepse afati i fundit ligjor për te njëjtën ankese ka qene data 03.08.2020 ora 16:00.

OSHP sqaron se neni 5 i LPP-së specifikon: Neni 5 Kalkulimi i afateve kohore

1. Afatet kohore të këtij ligji duhet të fillojnë në një ditë pune dhe të përfundojnë në një ditë pune. Afati kohor i shkon deri në 16:00 në ditën e skadimit. Autoriteti kontraktues mund të vendosë që të caktojë një kohë tjetër me kusht që ai është jo më herët se në ora 12:00 të ditës së skadimit.
2. Të shtunave, të dielave dhe festave zyrtare do të llogariten gjatë kalkulimit të afateve

kohore. Megjithatë, kur dita e fundit e afatit bie në një të shtunë, një të diel ose në një festë zyrtare afati kohor do të zgjatet për të përfshirë ditën e parë të punës pas kësaj.

Andaj OSHP duke marr parasysh faktin se OE ankues brenda afatit ligjor nuk ka parashtruar ankese në OSHP , por te njëjtën e ka parashtruar jashtë afatit ligjor, konstatojmë se ankesa dërguar me dt. 03.08.2020 në ora 17:57 e cila ankese protokollohet me dt. 04.08.2020 sipas orarit zyrtar, me numër te Protokollit 536/2020, duhet te hedhet si e pa lejuar për faktin se ankuesi ka humbur afatin ligjor për parashtrim të ankese në OSHP .

Organi Shqyrtues i Prokurimit sqaron se neni 9 paragrafi 1 te Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pran autoriteti kontraktues, parashtrimi të ankesave pran OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave specifikon: Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes dhe te dorëzohet brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga autoriteti kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të LPP-se.

Prandaj duke u nisur nga sqarimet e dhëna si me lart OSHP konstaton se ankesa e parashtruar në OSHP nga OE “VB INVEST” SH.P.K. Prishtinë, e dt. 03.08.2020 në ora 17:57 e cila ankese protokollohet me dt. 04.08.2020 sipas orarit zyrtar, me numër te Protokollit 536/2020, është parashtruar në OSHP jashtë afatit ligjor te parapara me nenin 108/A dhe 109 të LPP- së, si dhe nenin 9 të Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pran autoriteti kontraktues, parashtrimi të ankesave pran OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave, andaj e njëjta ankesë hedhet si e pa lejuar dhe nuk hynë në shqyrtim nga OSHP.

Kryesuesi i Sekretariatit të OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – Komuna e Lipjanit

1x1 OE “VB INVEST” SH.P.K. Prishtinë

1x1 Arhivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së

